



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas
Kuvendi Komunal
Skupština Opštine-Municipal Assembly
Nr.02.400/01-47954 dt.30/09/2024



Na osnovu člana 11, 12 i 40 zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi i člana 34 tačka 34.6 pod (c) statuta opštine Glogovac, kao i zakona br -260. Skupština Opštine Glogovac na redovnoj sednici održanoj: 30.09.2024, usvaja ovu:

ODLUKU O PRENOSU FINANSIJSKIH SREDSTAVA, SUBVENCIIJA I TRANSFERA

Član 1

Ovom Odlukom o transferu preusmerena su finansijska sredstva ekonomske kategorije Subvencije i Transferi u iznosu od 6.825,00 eura.

Član 2

Finansijska sredstva iz subvencija i transfera potprograma:

Planiranje ekonomskog razvoja (48001), izvor finansiranja (22) iznos od.....4,006.00 €,
Putna infrastruktura (18001), izvor finansiranja (21) iznos od 2,819.00 €.

Prebačeno u potprogram;

Poljoprivreda (47001), u Subvencijama i transferima (20), u iznosu od6,825.00 €.

Član 3

O sprovođenju ove odluke staraće se Direkcija za Budžet i Finansije.

Član 4

Ova odluka je stupila na snagu 15 dana od dana registracije i ocene zakonitosti od strane MALS-a, kao i 7 dana od objavljivanja na zvaničnom sajtu opštine.

Odluka se dostavlja:

- Predsedniku Opštine;
- Nadležna direkcija;
- Kancelarija Skupštine;
- Arhiv.



Predsedavajući Sednice SO

Gani Krasniqi

Obrazloženje

Pokrivanje obaveza koje proizilaze iz memoranduma o saradnji između Opštine Glogovac i IADK projekta „Poboljšanje zapošljavanja i mogućnosti za ostvarivanje prihoda u ruralnim područjima Kosova“ u iznosu od 6,825.00 evra.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Mjesja Org. Org. Jedin. Org. Unit: 102/HAPL/102
 Nr. i loqeve Broj shtanica No. pages: 44
 Nr. Prot. No. 2557-1/2024
 Data Datum Data: 21.10.2024
 Doliše PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Drenasit	
	Gani Krasniqi , Kryesues i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Jeton Qela , Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Avni Zogiani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
	Arton Ahmeti , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Bora Duli , U.d Drejtoresh e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 12.10.2024
Zyrtarët përgjegjës:		Referencë: 234/2024
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Shqiptar Ibra , Zyrtar i Lartë Ligjor për Përafrim me Acquis, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Drenasit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,

I nderuari Kryesues z. Krasniqi,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimi 02 Nr.400/01-47954 për transfer të mjeteve financiare, subvencione dhe transfere
<i>I miratuar më datë 30.09.2024</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.10.2024</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 04.10.2024</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), duke u bazuar vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë, si dhe pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Drinasit, jep konstatimet ligjore bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon transferin e mjeteve buxhetore në shumë prej 6,825.00 euro brenda kategorive buxhetore.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se procesi i transferimit të mjeteve financiare dhe i ndryshimeve të mjeteve financiare të ndara për projekte kapitale në kuadër të nën-programeve evidentohet edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (tutje ‘LMFPP’), plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (këtej e tutje referuar si ‘Ligji i Buxhetit 2024’), Udhëzimet Administrative Nr.04.2029 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2019 për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritizimin e Projekteve Kapitale (këtej e tutje referuar si ‘Udhëzimet Administrative’).
3. Kështu, në kuptim të transferit të mjeteve, neni 15, paragrafi 1 i Ligjit të Buxhetit 2024 përcakton mundësinë e transferit të shumave të ndara buxhetore, si në vijim:

Neni 15

Transferi i shumave të ndara buxhetore

1. Transferi i shumave të ndara buxhetore bëhet në përputhje me nenin 30 të LMFP-së, në nivel të nën-programit buxhetor dhe të kategorisë së shpenzimeve, sipas kritereve dhe procedurave të parapara me aktet nënligjore në fuqi. Përqindja e llogaritjes së ndarjes buxhetore të ndikuar negativisht përfshin të gjitha burimet e financimit.

4. Neni 30 i LMFP-së parasheh tre raste për transferin e një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të organizatës buxhetore, e që në këtë rast janë edhe Komunat, si në vijim:

30.1 Një organizatë buxhetore mundet, pa marrjen e miratimit paraprak nga Ministri, të transferojë deri në pesë për qind (5%) të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal; megjithatë, këto transfere nuk mund të bëhen në ndarjen buxhetore për paga dhe mëditje pa miratimin paraprak të Ministrit dhe, sipas rastit, Qeverisë ose Kuvendit, sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni.

30.2 Ministri, nëse merr një arsyetim të vlefshëm nga udhëheqësi i një organizate buxhetore, mund të autorizoj transferimin e një pjese të një ndarje të organizatës buxhetore në një ndarje tjetër të organizatës së njëjtë; me kusht që, vlera e shumës së transferuar të mos jetë më e madhe se pesëmbëdhjetë për qind (15%) e ndarjes së ndikuar negativisht.

30.3 Nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore, kërkon nga Ministri që të autorizojë transferimin e një shume që është më e madhe se pesëmbëdhjetë për qind 15 %, por më e vogël se njëzet e pesë për qind 25 % e ndarjes së ndikuar negativisht, atëherë Ministri mund të autorizoj një transfer të këtillë vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga Qeveria.

5. Logjika e ndjekur me këtë dispozitë është se transferi brenda nën-programeve mund të realizohet vetëm atëherë kur kemi aprovim paraprak nga Kuvendi Komunal. Në këtë rast, Ministria ka evidentuar se organizata buxhetor i ka transferuar/ mjetet nga projektet kapitale.
6. Mbetet evidente se Komuna me vendimin i cili është subjekt i shqyrtimit ka transferuar mjetet nga një kategori në tjetrën dhe ka transferuar/rialokuar mjetet nga projektet kapitale, mirëpo meqë vendimi nuk jep ndonjë informatë rreth përqindjes të shumës së transferuar, për realizimin e suksesshëm të tij mbetet kusht që Komuna të bashkëpunojë ngushtë me Departamentin e Buxhetit.
7. Në këtë kuptim, **Ministria konstaton se akti i Komunës së Drenasit është në përputhje me legjislacionin në fuqi** - mirëpo realizimi i suksesshëm i tij kushtëzohet me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri,

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

QEVERIA E KOSOVËS
 Republika e Kosovës
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministrište Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

02-VAP/170-2552/2024
 02.10.24



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministrište Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Arton Ahmeti, U. d. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Glllogocit Kryesuesi i Kuvendit të Komunitetit Glllogocit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbiln Hetemaj, U. d. Udhëheqës i Departamentit të Ligjor dhe Monitorim të Kontunave	Date: 02.10.2024 VI-02D-606
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
	2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për në MPTL	
Lloji i aktit:	Vendim	

Endëruar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 02 Nr. 400/01-47954 për transfer të mjeteve financiare, subvencione dhe transfere, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.
 Duke u bazuar në nenin 3 të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Kontunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendim 02 Nr. 400/01-47954 për transfer të mjeteve financiare, subvencione dhe transfere

I miratuar më datë: 30.09.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.10.2024



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-47954 dt. 30/09/2024

Republika e Kosovës Komuna e Drenasit (Glllogoc) Kuvendi i Komunës	
2008/01/01 - 2008/01/01	
Nr. i aktit: 47954	Data: 30/09/2024
Titulli: 02	Nr. i aktit: 47954

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të 18 ligjit nr. 03/11-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 34 pika 34.6 nën (c) të statutit të Komunës së Drenasit, si dhe ligjit nr. 08/L-260, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur në datë: 30.09.2024, miratoi këtë:

VENDIM PËR TRANSFER TË MJETEVE FINANCIARE, SUBVENCIONE DHE TRANSFERENCË

Neni 1

Me këtë vendim për transfer, rëndësishon mjetet financiare të kategorisë ekonomike Subvencione dhe Transferencë në shumën 6,825.00 euro.

Neni 2

Mjetet financiare nga Subvencione dhe Transferencë të nën-programeve:
Planifikimi i zhvillimit ekonomik (18001), buxheti i financimit (22) shuma prej: 4,006.00 €
Infrastruktura rrugore (18001), buxheti i financimit (21) shuma prej: 2,819.00 €

Transferimi në nën-programin:
Bujqësia (17001), në Subvencione dhe Transferencë (20), në shumën: 6,825.00 €.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorin për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimi të ligjshmerisë nga MAP-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Udhëzimin zyrtar të Komunës.



- Vendimi i dërgohet:
- Zyres së Kryetarit
 - Drejtorit të Përkallës;
 - Zyres së Kuvendit;
 - Arkivit.